



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:226556

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05483617

**C.nr.3283/23**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN **Departamenti i përgjithshëm** Divizioni civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtoren profesionale K.R. në çështjen juridiko kontestimore të paditësit B.D. nga Prizreni të cilin me autorizim e përfaqësojnë avokat B.K. dhe avokate F.G. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës MASHT- Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, jashtë seance, me datë **20.03.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. **APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.D. nga Prizreni.
- II. **DETYROHET** e paditura MASHT - Prishtinë, që paditësit B.D. në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për vitin 2022 (respektivisht prej datës 01.01.2022 e deri më datë 15.11.2022 ), për 204 ditë pune t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 408.00 (katërqind e tetë) euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë dt. 25.10.2023 , në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00 (njëqind e njëzet e katër) euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi B.D. nga Prizreni, përmes të autorizuarve të tij avokat av. B.K. dhe F.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 25.10.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – MASHT- Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i ushqimit në punë.

Të autorizuarit e paditësit në padi kanë theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren dhe paditësit i takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2022, nga 2 euro në ditë për çdo ditë pune. Respektivisht për 204 ditë pune të ia paguaj shumën prej 408 euro, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për pagesën e shujtave pranë DKA-së deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi

që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes Avokaturës Shtetërore në Prishtinë, si përfaqësuese e të paditurës në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Në përgjigje në padi ka theksuar se një kompensim i tillë nuk është i paraparë me ligjin e punës, andaj rrjedhimisht nuk mund të jetë as detyrim për të paditurën. Ka ardhur në konkluzion se kërkesëpadia është në kundërshtim me vetë Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 pasi që kjo kontratë tani më nuk është në fuqi, gjithashtu ka shtuar se nuk ekzistojnë mundësitë institucionale – financiare që të i paguhen paditësit ditët e ushqimit, si dhe ka deklaruar se paditësi nuk ka dëshmuar se është anëtar i sindikatës e paraparë me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1.1 të kontratës kolektive për arsim. Prandaj e paditura i propozon Gjykatës që pas administrimit të provave të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim kryesor të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 62/2023 të datës 30.03.2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.D. është në marrëdhënie pune- pranë QBMK “Nënë Tereza” në Prizren dhe i njëjti në vitin 2022 për periudhën nga data 01.01.2022 e deri më 15.11.2022 ka punuar gjithsej 204 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që e njëjta është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.2056 e datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.2056 e datës 18.04.2017, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “*Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...*”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës së shqyrtimit kryesor, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë,*

*gjkata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.*”, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit-mësimdhënës, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit me numër 2056 e datës 18.04.2017, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditësin B.D. kërkesa është bërë e arritshme për 204 ditë pune për vitin 2022, apo shuma e përgjithshme prej 408 (katërqind e tetë) euro.

Gjkata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (25.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Gjkata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.3283/23 më datë 20.03.2024**

**G j y q t a r j a**

**Edije Sezairi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.